

## KËRKESE PËR INFORMACION

|             |   |                         |
|-------------|---|-------------------------|
| <b>Nga:</b> | <b>Adresa postare:</b>                        | <b>Data:</b> 30.12.2025 |
|             | <b>Adresa elektronike:</b><br><b>Celular:</b> |                         |

### Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

#### **Hekurudha Shqiptare**

Sa përqind e punimeve të projektit “Tiranë - Durrës - Rinas” është realizuar deri në momentin aktual?

Cilat janë segmentet ku punimet kanë përfunduar dhe cilat janë ende në proces ndërtimi?

Cilat kompani janë kontraktuar për fazat e ndërtimit dhe mirëmbajtjes, dhe cila është vlera përkatëse e kontratave?

A ka pasur vonesa, penalitete ose shtesa financiare gjatë zbatimit të kontratave?

Cilat janë masat e marra për sigurinë e punonjësve dhe komuniteteve përreth gjatë fazës së ndërtimit?

A janë kryer auditime ose monitorime të pavarura për cilësinë e punimeve? Nëse po, ju lutem të vihen në dispozicion raportet përkatëse.

Cilat janë parashikimet për fazën e operimit të linjës - përfshirë numrin e trenave që do të vihen në qarkullim, shpeshësinë e udhëtimeve dhe parashikimet për tarifën e udhëtimit?

A janë përfunduar sistemet e sinjalizimit dhe të elektrifikimit përgjatë linjës, dhe cilat standarde teknike po përdoren për to?

A parashikohet eliminimi gradual i kalimeve në nivel pas fillimit të funksionimit të linjës, dhe nëse po, sipas cilit plan kohe?

**Të tjera të dhëna**

- Kjo kërkesë dhe hartimi i saj bazohet në “Ligjin për të Drejtën e Informimit”, rrjedhimisht sqarohet se pritja për një përgjigje nga institucioni juaj është **10 ditë pune**, nëse ajo nuk kthehet, do t’i drejtohem Komisionerit për të Drejtën e Informimit;
- Informacioni i kërkuar mund të përfshihet në një publikim në medianë në internet
- Kjo kërkesë vjen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008. “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

**Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni:** Informacionin e kërkojmë në rrugë elektronike, në formatin “Pdf” dhe jo të skanuar, sjellë në adresën postare elektronike:

**Vetëm për përdorim zyrtar**

|                                     |                                   |   |
|-------------------------------------|-----------------------------------|---|
| Data e marrjes:<br><br>30/12/ 2025: | Numri rendor i kërkesës:<br><br>7 | Komente: <a href="#">Kërkesa do të trajtohet nga Drejtoria e Menaxhimit dhe Zbatimit të Projekteve dhe do vihet në dispozicion sipas formës së kërkuar nga ligji.</a> |
|-------------------------------------|-----------------------------------|---|

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

- ❖ Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.
- ❖ Drejtoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.

- ❖ Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.